



Komuna e Lipjanit

KONTRATA PËR SHËRBIME

E lidhur në Lipjan më 30/10/2019 ndërmjet palëve:

**Komuna e Lipjanit përfaqësuar nga drejtori i prokurimit z.Adem Duriqi në vazhdim (permendet)
Autoriteti kontraktues dhe**

Ofruesit te Shërbimeve> Naser Sadiku B.I., rruga Skenderbeu Lipjan i përfaqësuar Naser Sadiku vazhdim do të përdoret (“Kontraktuesi”), **nga ana tjetër:**

Titulli i kontratës: **Shërbimet e akomodimit dhe fjetjes se rezidentëve të Shtëpisë së Komunitetit-ritenderim** me numër Identifikues *613 19 049 236*

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë Akomodimi i rezidentëve të shtëpisë së komuniteteve për shtatë ditë e . Për akomodim të këtyre rezidentëve kontraktuesi **duhet t'i ketëtë rezervuara në hotel minimumi 7 dhoma gjumi për 7 netë, gjatë muaji tetor dhe i duhet t'i ketë të rezervuara minimumi 7 dhoma gjumi për 7 netë, gjatë muaji nëntor** sipas kërkesë së menaxheres së shtëpisë së komuniteteve, sallën e ushqimit që të mund të shërbehen me ushqim në të njëjtën kohë të gjithë klientët, menya e drekës duhet të përmbajë minimumi 3 lloj gjellra me mish që të mund të zgjedhin klientët dhe në çdo racion duhet të ju sigurohet nga një pije. Për pushim janë gjithsejt 18 persona që dmth për 7 ditë do të ushqehen me nga 3 racione (mëngjez, drekë dhe darkë) Kontraktuesi do të sigurojë transportin e rezidentëve të shtëpisë së komuniteteve nga Lipjani deri te hoteli që kontraktohet për pushim dhe kthimin për lipjan pas përfundimit të pushimit.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me [më 30/10/2019 dhe përfundon me 30/11/2019].

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 1 ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi i [kryerjes së shërbimeve do të jetë pushimorja në Prevallë].

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës është **7924.00 €; shtatë mijë e nëntëqind e njëzet e katër / Euro.**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve

gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas brezës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës në dy pjesë pjesa e parë do të kryhet pas pranimit përfundimit të shërbimeve që dmth pas kthimit të rezidentëve në muajin tetor , menaxheri i kontratës do të hartojë raportin me shkrim për kryerjen e shërbimeve në bazë të të cilit mundësohet pagesa dhe pjesa e dytë do të paguhet pas marrjes së shërbimeve në muajin nëntorë dhe hartimit të raportit nga menaxheri i kontratës.]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i [shërbimeve] duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit, kontraktuesi do të ofrojë ushqimin në bazë të standardeve si nga cilësia dhe sasia të cilën e ka ofruar me rastin e ofertimit, të ofrojë komoditet për gjumë të rehatshëm për rezidentët e shtëpisë së komunitetit në Lipjan si dhe për përcjellësit e tyre.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë të gjitha shërbimet] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik

nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërrprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik 1 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res-judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërrprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) si rezultat i forcës madhore,

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Gjykata Themelore në Lipjan* në pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [Shqip] [në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Naser Sadiku	Emri:	Adem Duriqi
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Drejtor i drejtorisë së prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	30.04.2019	Data:	30.04.2019
Vula:		Vula:	

Rezervimi i dhomave dhe ushqimit për muajin tetor

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për një natë	ÇMIMI PËR 7 NETË	SHUMA NË € 4x5
1.	REZERVIMI i 8 dhomave të gjumi për 7 netë, për 18 persona	Dhoma gjumi	7	37.00	296.00	2072.00
Totali i Përgjithshëm:						2072.00

Tabela 2

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për një racion	SHUMA NË €
1.	Sigurimi i mëngjesit 7 ditë 13 persona	racion	126	5.00	630.00
2	Sigurimi i drekës për 8 ditë 13 persona	racion	126	5.00	630.00
3	Sigurimi i darkës për 8 ditë 13 persona	racione	126	5.00	630.00
	Shuma e përgjithshme tabela 2				1890.00
	Shuma e përgjithshme tabela 1+2				3962

Rezervimi i dhomave dhe ushqimit për muajin nëntor

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për një natë	ÇMIMI PËR 7 NETË	SHUMA NË € 4x5
1.	REZERVIMI i 8 dhomave të gjumi për 7 netë, për 18 persona	Dhoma gjumi	7	37.00	296.00	2072.00
Totali i Përgjithshëm:						2072.00

Tabela2

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për një racion	SHUMA NË €
-------------------	------------	--------	-------	----------------------	------------

1.	Sigurimi i mëngjesit 7 ditë 13 persona	racion	126	5.00	630.00
2	Sigurimi i drekës për 8 ditë 13 persona	racion	126	5.00	630.00
3	Sigurimi i darkës për 8 ditë 13 persona	racione	126	5.00	630.00
	Shuma e përgjithshme tabela 2				1890.00
	Shuma e përgjithshme tabela 1+2				3962

1	2	vlera
1.	Rezervimi për muajin tetor	3962.00
2	Rezervimi për muajin nëntor	3962.00
	Shuma e përgjithshme	7924.00